



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

fhi360
THE SCIENCE OF IMPROVING LIVES

ICNL
INTERNATIONAL CENTER
FOR NOT-FOR-PROFIT LAW



2019 INDEKSI I QENDRUESHMËRISË SË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE SHQIPËRIA KORRIK 2020


SHQIPËRIA QENDRUESHMËRIA E PËRGJITHSHME E OSHC-VE: 3.7

Qëndrueshmëria e përgjithshme e sektorit të shoqërisë civile në Shqipëri nuk pësoi ndryshime gjatë vitit 2019, megjithëse përmirësime u vunë re në disa dimensione: (a) kapaciteti organizativ – OSHC-të demonstuan kapacitet më të fortë organizativ duke përfituar nga programet e mbështetjes të donatorëve; (b) infrastruktura e sektorit - lançimi i Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri (QKBSHC) përmirësoi infrastrukturën e sektorit; (c) ofrimi i shërbimeve - OSHC-të shqiptare u bënë pjesë aktive në reagimin e menjëhershëm ndaj komuniteteve të prekura nga tërmeti, duke përmirësuar ofrimin e shërbimeve; dhe (d) advokacia - OSHC-të vijuan të tregojnë advokaci të fortë përmes angazhimit aktiv në nisma të rëndësishme dhe demonstuan këmbëngulje në ndjekjen e misioneve të tyre. Qëndrueshmëria financiare vijon të jetë dimensionimi më i dobët i sektorit.

ALBANIA

Capital: Tirana
Population: 3,074,579
GDP per capita (PPP): \$12,500
Human Development Index: High (0.791)
Freedom in the World: Partly Free (67/100)

OVERALL CSO SUSTAINABILITY: 3.7



MJEDISI LIGJOR: 3.7

Mjedisi ligjor për OSHC-të në Shqipëri nuk pësoi ndryshime gjatë vitit 2019. Qeveria miratoi Udhërrëfyesin e rishikuar për 2019-2023. Duke marrë në konsideratë zbatimin e dobët të Udhërrëfyesit të vitit 2015, OSHC-të kanë prishmëri të ulëta për realizimin e Udhërrëfyesit të rishikuar.

> Ndërkohë që legjislati adreson qartazi regjistrimin dhe funksionimin e OSHC-ve, proceset e regjistrimit, ndryshimit të statutit dhe çregjistrimit janë të centralizuara, burokratike, të gjata, të kushtueshme, veçanërisht për OSHC-të jashtë Tiranës.

> Ligji për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare hyri në fuqi në janar 2019, por OSHC-të besojnë se ai paraqet një rrezik të lartë potencial për ndërhyrjen e shtetit në veprimet e tyre.

> Aktet nënligjore për Ligjin mbi Vullnetarizmin u miratuan në vitin 2019, sidoqoftë, ligji ka nevojë për zhvillim të mëtejshëm, për shembull t'i mundësojë OSHC-ve të mbështeten tek vullnetarët për të funksionuar në rast se u mungon financimi.

> Ligji për Ndërmarrjet Sociale vijon të jetë problematik pasi OSHC-ve që u është dhënë statusi i ndërmarrjes sociale kanë aftësi të kufizuara për të gjeneruar të ardhura nga aktiviteti i tyre.

> Trajtimi fiskal i OSHC-ve nga ana e qeverisë nuk pësoi ndryshime të mëdha gjatë vitit 2019. OSHC-të trajtohen në mënyrë të ngjashme me organet e tjera të tatueshme.

> Burime të pakta ligjore janë në dispozicion të OSHC-ve, veçanërisht për ato me qendër jashtë Tiranës.

KAPACITETI ORGANIZATIV: 3.6

Kapaciteti organizativ i OSHC-ve pati një përmirësim të lehtë në 2019 si rezultat i programeve të donatorëve të fokusuar në ngritjen e kapaciteteve gjatë viteve të fundit. OSHC-të në nivelin vendor kanë lidhje më të forta me komunitetet sesa organizatat kombëtare, por burimet dhe kapacitetet e tyre janë të kufizuara. Shumë OSHC bazohen në projekte, me pjesën më të madhe të fondeve të tyre nga BE, gjë që kërkon planifikim të hollësishëm dhe dokumentacion administrativ. Si pasojë, OSHC-të investojnë shumë nga koha e tyre në detyra administrative sesa në ndërtimin e mbështetjes së fortë me individë dhe grupe të interesuara. Shumica e OSHC-ve kanë struktura dhe procese formale të menaxhimit, megjithëse ato jo gjithmonë funksionojnë në mënyrë efektive. OSHC-të shqiptare e konsiderojnë të vështirë të mbajnë personel të përhershëm dhe me kohë të plotë, kryesisht sepse ato janë të kufizuara nga financimet e bazuara në projekte. OSHC-të në zonat rurale dhe të largëta përballen me vështirësi në sigurimin e burimeve njerëzore të kualifikuara për shkak të migrimit dhe shpopullimit të këtyre zonave. OSHC-të kontraktajnë gjithnjë e më shumë ekspertë mbi baza afatshkurtra në varësi të kohëzgjatjes së projekteve të financuara. Angazhimi vullnetar në Shqipëri mbetet i ulët. OSHC-të përdorin gjithnjë e më shumë teknologji moderne, dhe kanë qenë në gjendje të rrisin aksesin e tyre në pajisjet e zyrës në vitet e fundit me mbështetjen e programeve të donatorëve.

QËNDRUESHMERIA FINANCIARE: 4.4

Qëndrueshmëria financiare e OSHC-ve nuk ndryshoi gjatë vitit 2019. Financimi nga donatorët ndërkombëtarë vazhdoi, ndërsa mbështetja e qeverisë mbeti e ulët. Mungesa e fondeve vazhdoi të jetë shqetësuese, veçanërisht për OSHC-të më të vogla, dhe ka një mungesë të larmisë në modalitetet e financimit. AMSHC mbeti burimi kryesor i financimit të qeverisë për OSHC-të, me shtatë grante më shumë se gjatë vitit të kaluar. Fushat prioritare për financim përfshinin aktivizmin e të rinjve, shoqërinë civile në procesin e integritimit evropian, shërbimet sociale dhe mjedisin, turizmin dhe zhvillimin e integruar. Një kornizë jo e plotë ligjore e pengon qeverisjen lokale të zhvillojë mekanizma për t'i bërë fondet lokale të disponueshme për OSHC-të. OSHC-të më të mëdha vazhduan të mbështeten kryesisht tek grantet e donatorëve ndërkombëtarë, me pjesën më të madhe të financimeve nga BE. Grantet e donatorëve ndërkombëtarë shpesh përfshijnë komponentë nëngrantimi, në mënyrë që fondet të jenë të disponueshme edhe për organizatat e vogla. Në përgjithësi, OSHC-të shqiptare nuk kanë kapacitete organizative dhe burime të nevojshme për të mbledhur donacione përmes aktiviteteve për ngritjen e fondeve. Sidoqoftë, ndërsa institucionet publike ishin përfituesit kryesorë të mbështetjes ndërkombëtare për ndihmën ndaj tërmetit, shumica e donatorëve individualë i kanalizuan donacionet e tyre përmes OSHC-ve. Disa OSHC janë të angazhuara në ofrimin e shërbimeve si një formë alternative e gjenerimit të të ardhurave. Duke filluar nga viti 2019, OSHC-të mund të aplikojnë për statusin e ndërmarrjeve sociale. OSHC-të shqetësohen gjithnjë e më shumë për trajtimin e tyre nga autoritetet tatimore, qeverisja lokale dhe bankat, të cilat nuk bëjnë dallimin midis njësive jofitimprurëse dhe atyre fitimprurëse. OSHC-të u nënshtrohen Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse, të cilat kërkojnë auditime të pavarura të detyrueshme të OSHC-ve, me përjashtim të OSHC-ve të vogla.

ADVOKIMI: 3.2

Advokimi i OSHC-ve vazhdoi të jetë i fortë në vitin 2019. Përkundër sfidave të vazhdueshme, OSHC-të angazhohen në mënyrë aktive në proceset e vendimmarrjes dhe politikë-bërjes si në nivel vendor dhe kombëtar.

> Zbatimi i ligjit Nr. 146/2014 për Njoftimin dhe Konsultimin Publik mbetet problematik kryesisht për shkak të mungesës së një organi mbikëqyrës dhe sanksioneve. Njoftimet e konsultimeve publike publikohen dobët dhe konsultimet jo gjithmonë mbahen, edhe kur konsultimet zhvillohen, komentet dhe rekomandimet e OSHC-ve zakonisht nuk merren në konsideratë.

> Ligji Nr. 54/2019 mbi nismën ligjore të votuesve u miratua në korrik. Ky ligj përcakton procedurat për votuesit që marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes duke lejuar një minimum prej 20,000 votues të propozojnë projektligje.

> OSHC-të u angazhuan në disa nisma të rëndësishme advokacie në vitin 2019, veçanërisht Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit Kombëtar, e cila organizoi protesta të përditshme për të ruajtur ndërtesën historike të Teatrit Kombëtar. OSHC-të gjithashtu protestuan ndaj paketave Anti-Shpifje dhe Anti-KÇK. OSHC-të mjedisore ishin në krye të një koalicioni që punoi për të parandaluar ndërtimin e hidrocentraleve dhe për të mbrojtur lumin Vjosa.

> Koalicioni i OSHC-ve rome dhe egjiptiane, arriti të bindë bashkinë e Tiranës për të eliminuar tarifën e regjistrimit për fëmijët e familjeve rome dhe egjiptiane që ndjekin arsimin parashkollor publik. Komiteti Shqiptar i Helsinkit advokoi për ndërtimin e një burgu për njerëzit me probleme të shëndetit mendor. Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës (SMBB), u themelua në vitin 2019 nga një grup minatorësh nga Bulqiza. OSHC-të gjithashtu advokuan për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në vitin 2019.

> KKSHC zgjodhi anëtarët e rinj në vitin 2019 por ka qenë përgjithësisht joaktiv.

OFRIMI I SHËRBIMEVE: 3.5

Ofrimi i shërbimeve të OSHC-ve u përmirësua disi në vitin 2019, pasi OSHC-të u mobilizuan shpejt për të përmbushur nevojat e popullatës të prekur nga tërmeti i muajit nëntor. OSHC-të arritën konsensusin për të vazhduar si pjesë e Komitetit Kombëtar të Rindërtimit pasi Kryeministri propozoi që të gjitha fondet nga shteti dhe institucionet private të bëhen një fond i vetëm kombëtar, ku secila palë monitoron fondet e veta. OSHC-të gjithashtu vazhdojnë të ofrojnë shërbime në një sërë fushash të tjera. Mbështetja e OSHC-ve ka një rëndësi të jashtëzakonshme në fushat në të cilat shërbimet publike janë joadekuate ose mungojnë. OSHC-të ofrojnë shumë shërbime sociale për grupet në nevojë, përfshirë komunitetet rome dhe egjiptiane, fëmijët, vajzat dhe gratë, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit. Sidoqoftë, ofrimi i shërbimeve nga OSHC-të varet nga donatorët, dhe OSHC-të shpesh hasin vështirësi të sigurojnë fonde të mjaftueshme. OSHC-të që kanë një prani të fortë në komunitetet lokale, kanë një kuptim të mirë të nevojave të komuniteteve që përfaqësojnë dhe mbështesin. Shumica e OSHC-ve ende nuk e kanë inkorporuar sipërmarrjen si një burim alternativ i të ardhurave, kjo ose për shkak se u mungon interesi për zhvillimin e shërbimeve me pagesë ose sepse u mungon aftësia për të planifikuar dhe menaxhuar shërbime të tilla. Ndërsa qeveria qendrore dhe autoritetet vendore vlerësojnë gjithnjë e më shumë rolin e shoqërisë civile në ofrimin e shërbimeve, pak progres është bërë në vitin 2019 për të siguruar mbështetjen e tyre të qëndrueshme financiare. Ligji i ri i prokurimit publik pritet të rrisë angazhimin e OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve.

INFRASTRUKTURA E SEKTORIT: 3.6

Infrastruktura që mbështet sektorin e OSHC-ve u përmirësua ndjeshëm në vitin 2019 pasi nën-grantet e reja dhe programet e asistencës teknike ofruan mundësi për OSHC-të shqiptare, veçanërisht organizatat më të vogla, për të rritur burimet dhe kapacitetet e tyre. Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile (QKBShC) u ngrit për të ndihmuar zhvillimin e sektorit të OSHC-ve në Shqipëri. QKBShC ka dy qendra rajonale, duke siguruar mbulim të gjerë territorial. Që nga themelimi i saj, QKBShC ka ofruar trajnime të rregullta dhe mbështetje të tjera, të tilla si informim mbi mundësitë e financimit, nismave dhe studimeve. Në vitin 2019 OSHC-të menaxhuan shumë projekte nën-grantimi të financuara nga jashtë. Skemat e nën-grantimit zakonisht përfshijnë ngritje kapacitetesh për OSHC-të e

vogla, me kapacitete të kufizuara në menaxhimin e projekteve dhe temat specifike të programeve. Gjatë vitit, OSHC-të u angazhuan gjithnjë e më shumë në rrjete dhe koalicione formale dhe joformale, si dhe rrjete përtej sektorit. Bashkëpunimi midis OSHC-ve dhe bizneseve mbetet ende i pazhvilluar. Media dhe OSHC-të janë gjithnjë e më të interesuara për të bashkëpunuar në adresimin e problematikës së tkurrjes së hapësirës qytetare. Media gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në promovimin e veprimtarisë së OSHC-ve. Ekziston një bashkëpunim i kufizuar midis OSHC-ve dhe institucioneve qeveritare për shkak të transparencës së kufizuar të institucioneve publike dhe nivelit të ulët të besimit në institucionet qeveritare nga OSHC-të.

IMAZHI PUBLIK: 3.7

Imazhi publik i OSHC-ve nuk pësoi ndryshime të mëdha në vitin 2019. OSHC-të hasen vështirësi për të pasur mbulim mediatik, dhe e konsiderojnë median kombëtare pothuajse të pamundur për t'u qasur. Nga ana tjetër, mediat lokale janë relativisht më të arritshme. Shumë media kërkojnë pagesa për të mbuluar veprimtaritë e OSHC-ve. Megjithatë, media publike, ka një hapësirë të dedikuar për pakicat duke ofruar një mbulim të OSHC-ve që punojnë për çështje të pakicave. Media vazhdon të shprehë pikëpamje kritike ndaj OSHC-ve.

- > **Publiku demonstroi besimin e tij tek OSHC-të gjatë vitit 2019, duke ia besuar OSHC-ve e jo institucioneve shtetërore donacionet e tyre për t'i ardhur në ndihmë të prekurve nga tërmeti.**
- > **Institucionet shtetërore priren të kenë perceptime pozitive për organizatat e përfshira në ofrimin e shërbimeve dhe negative për organizatat e përfshira në aktivitete advokuese apo mbikëqyrëse.**
- > **Gjatë vitit 2019, zyrtarë të lartë të qeverisë u përfshinë në përbaltjen e OSHC-ve që veprojnë si media.**
- > **Bashkëpunimi midis sektorit privat dhe OSHC-ve është i pazhvilluar, dhe mbështetja e biznesit për OSHC-të mbetet e ulët, pjesërisht për shkak se komuniteti i biznesit vazhdon të ketë kuptim të kufizuar të rolit të OSHC-ve në shoqëri.**
- > **Shumica e OSHC-ve nuk komunikojnë në mënyrë efektive. Vetëm një numër i vogël i OSHC-ve kanë staf të dedikuar për të mbuluar çështjet e lidhura me komunikimin dhe marrëdhëniet me publikun.**
- > **Edhe pse një numër i konsiderueshëm i OSHC-ve advokojnë për transparencë dhe qeverisje të mirë, sektori shfaq pak progres në këtë drejtim.**